

E drejta për informim

Newsletter mujor mbi mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për të Drejtën e Informimit

Newsletter është publikim i Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Fokusi i muajit

Kostoja e shërbimit

Kodi i Procedurave Administrative parashikon si parim të përgjithshëm "Parimin e mospagimit në procedurat administrative" dhe konkretisht parashikon në pikën 1 të nenit 19 se "Procedura administrative është pa pagesë, përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe".

Një nen i vecantë i dedikohet "Kostos së shërbimit" në Ligjin nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", ku përcaktohet se:

"Dhënia e informacionit mund të bëhet kundrejt një tarife, të përcaktuar më parë dhe të bërë publike nga autoriteti publik në faqen e tij të internetit dhe në mjediset e pritjes së publikut. Tarifa është kostoja e riprodhimit të informacionit të kërkuar dhe, kur është rasti, e dërgimit të tij. Informacioni i kërkuar në rrugë elektronike jepet falas. Kostoja e riprodhimit nuk mund të jetë më e lartë se kostoja reale e materialit, mbi të cilin riprodhohet informacioni. Kostoja e dërgimit nuk mund të jetë më e lartë se kostoja mesatare e të njëjtit shërbim në treg. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale shqyrton periodikisht, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, tarifat e bëra publike nga autoritetet publike dhe, sipas rastit, urdhëron ndryshimin e tyre.

Bazuar në ligjin "Për të Drejtën e Informimit, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë kanë miratuar Udhëzimin e Përbashkët nr. 12, datë 21.7.2020 "Për përcaktimin e numrit të faqeve për të cilat informacioni përfitohet falas, rastet e përjashtimit nga pagesa e tarifës, si dhe rregulla për mënyrën e kryerjes së pagesës për pajisjen me informacion që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike". Për më shumë informacion rreth Udhëzimit lexoni në faqen 4 dhe 5.

Përmbledhje mujore e vendimeve dhe rekomandimeve

Vendim Nr. 25 - Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

Vendim Nr. 26 - Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit

Vendimmarrja e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP), gjatë muajit maj, ka dhënë dy vendime urdhërimi në zbatim të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" (LDI).

Me anë të Vendimit nr. 26, datë 12.05.2021, KDIMDP ka pranuar ankesën për refuzim dhënie informacioni ndaj Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (Autoriteti Publik) ku kërkohet: *Autoriteti publik që ka paraqitur dosjen për miratimin e Vendimit të Kufijve të Zonave të Mbrojtura pranë KKT-së; Kopje e përmbledhjes së vërejtjeve apo propozimeve gjatë takimit publik, që i bashkëlidhen projektit të dokumentit të planifikimit, të paraqitur për miratim, referuar nenit 24, pika 4 e ligjit nr. 107/2014; Qëndrimi e Autoritetit Publik lidhur me propozimin e ardhur.*

Komisioneri pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore. Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, Zyra e Komisionerit, kërkoi nga Autoriteti Publik qëndrimin në lidhje me pretendimin e ngritur nga ankuesi si dhe sqarime në lidhje me disponimin e dokumentacionit të kërkuar.

Autoriteti Publik pas kërkesës së Zyrës së Komisionerit ka rikonfirmuar qëndrimin e mbajtur në përgjigjen dhënë kërkuarës së informacionit, duke theksuar se për pyetjen e dytë dhe të tretë: *Autoriteti Publik nuk është institucioni kompetent në trajtimin e kërkesës për informacion dhe dokumentacioni i kërkuar nuk është i prodhuar prej saj.*

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës, parashtrimeve të paraqitura nga Autoriteti Publik dhe dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit administrativ, Komisioneri vlerësoi se, argumentet e parashtruara nga Autoriteti Publik, sipas të cilave, ai nuk është institucioni kompetent në trajtimin e kërkesës për informacion dhe

TRANSPARENCA E AUTORITETEVE
PUBLIKE ËSHTË PARADHOMA
E MIRËQEVERISJES

VIZITONI WWW.IDP.AL

#informim #transparencë #vendim

dokumentacioni i kërkuar nuk është i prodhuar prej tij, rezultojnë të pabazuara në ligj.

Në pikën 2, të neni 2 të LDI, parashikohet se: "Informacion publik është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik". Në këtë kuptim, dokumentet të cilat disponohen nga ana e Autoritetit Publik, pavarësisht nëse janë prodhuar ose jo nga ky i fundit, përbëjnë informacion publik dhe bazuar në këtë dispozitë duhet të vendosen në dispozicion të kërkuar në formën e zotëruar.

Gjithashtu, Autoriteti Publik në bërjen publike të dokumentit të kërkuar, duhet të mbajë në konsideratë parashikimin sipas pikës 6 të nenit 17 të Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", ku përcaktohet se: "Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarës. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim".

Në përfundim të procesit administrativ të shqyrtimit të ankesave KDIMDP vendosi urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënie informacionit të kërkuar në pikën dy dhe tre të kërkesës.

Në vendimarrjen e tij, Zyra e Komisionerit informon palët për të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja e vendimit.

Për më shumë informacion mund të lexoni të plotë vendimet në faqen e KDIMDP www.idp.al.

VERIFIKIM I REKOMANDIMEVE TË KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Duke nisur nga muaji maj, Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka nisur procesin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve ndaj Njësive të Vetëqeverisjes Vendore për vitin 2020 dhe vitin 2021.



UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 12, datë 21.7.2020

PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË FAQEVE PËR TË CILAT INFORMACIONI PËRFITOHET FALAS, RASTET E PËRJASHTIMIT NGA PAGESA E TARIFËS, SI DHE RREGULLA PËR MËNYRËN E KRYERJES SË PAGESËS PËR PAJISJEN ME INFORMACION QË PRODHOHET OSE MBAHET NGA AUTORITETET PUBLIKE

Në mbështetje, të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 13 dhe të pikës 3, të nenit 16, të ligjit nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit", ministri i Drejtësisë dhe ministri i Financave dhe Ekonomisë

UDHËZOJNË:

1. Personat e regjistruar në skemat e ndihmës shoqërore, si dhe subjektet përfituese, sipas ligjit nr. 111/2017, "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti", e përfitojnë informacionin dhe/ ose dokumentacionin pa pagesë deri në 20 fletë, për çdo kërkesë ose në vlerën ekuivalente kur informacioni jepet në një format tjetër, pas vërtetimit të statusit përkatës.

2. Subjektet përfituese janë:

- a) personat, të cilët janë përfitues të skemave të mbrojtjes sociale;
- b) viktimat e dhunës në familje;
- c) viktimat të abuzuar seksualisht dhe viktimat të trafikimit të qenieve njerëzore, në çdo fazë të procedimit penal;
- d) viktimat të mitur dhe të miturve në konflikt me ligjin, në çdo fazë të procedimit penal;
- e) fëmijët, të cilët jetojnë në institucionet e përkujdesjes shoqërore;
- f) fëmijët nën kujdestari, të cilët kërkojnë të nisnin një proces pa miratimin e kujdestarit të tyre ligjor ose kundër kujdestarit të tyre ligjor;
- g) personat që përfitojnë nga pagesa për aftësinë e kufizuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën dhe shërbimet shoqërore, duke përfshirë edhe personat që përfitojnë nga statusi i të verbrit;
- h) personat, të cilët i nënshtrohen trajtimit të pavullnetshëm në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor, sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi për shëndetin mendor;
- i) personat, të cilët i nënshtrohen trajtimit vullnetar në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor për sëmundjet e rënda mendore;
- j) personat, ndaj të cilëve kërkohet heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar, në çdo fazë të këtij procesi;
- k) personat, të cilëve u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, që kërkojnë të nisnin një proces kundër kujdestarit të tyre ligjor, për rifitimin e zotësisë për të vepruar, pa miratimin e kujdestarit ligjor;
- l) personat, të cilëve u është cenuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim, bazuar në vendimin e organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.
- m) personat që provojnë se kanë të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme për të përballuar shpenzimet, që do të thotë nëse të ardhurat e tyre janë më të ulëta se niveli i pagesë minimale të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi.

3. Pas marrjes së kërkesës për informim nga subjekti kërkues, autoriteti publik, llogarit shumën që duhet paguar për riprodhimin dhe sipas rastit, për dërgimin e informacionit dhe njofton menjëherë kërkuesin.

4. Riprodhimi i dokumenteve të kërkuara do të bëhet nga drejtoria/sektori përkatës, me mjetet e riprodhimit që disponon autoriteti publik.

5. Subjekti kërkues bën pagesën e tarifës së përcaktuar nga autoriteti publik, për llogari të autoritetit publik, pranë një banke të nivelit të dytë. Një kopje të mandati të pagesës, subjekti kërkues ia bashkëlidh kërkesës, drejtuar autoritetit përkatës.

6. Me pagesën e tarifës përkatëse dhe paraqitjen e mandatit bankar, pranë autoritetit publik, dokumentet e kërkuara nga kërkuesi i dërgohen me postë ose i dorëzohen menjëherë të interesuarit.

7. Përfshihen nga fusha e zbatimit të këtij udhëzimi, subjektet për të cilat marrja e shërbimit, përcaktohet me ligj që të jetë pa pagesë.

8. Ngarkohen me zbatimin e këtij udhëzimi, autoritetet publike, që kanë detyrimin për dhënien e informacionit të kërkuar nga kërkuesi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Etilda Gjonaj (Saliu)

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj